



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA006

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 8 korrik 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtësit të viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagendra

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 58, 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit lidhur me apelin e z. Jakup Krasniqi të vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të tij.<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 nëntor 2020, z. Krasniqi u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 tetor 2020<sup>2</sup> dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë në të njëjtën ditë.<sup>3</sup>
2. Më 25 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kontestuar në të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi.<sup>4</sup>
3. Më 7 korrik 2021, z. Krasniqi parashtroi Apelin.<sup>5</sup>

## II. KLASIFIKIMI

4. Apeli është i klasifikuar si konfidencial dhe rrjedhimisht ky vendimi do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të

---

<sup>1</sup> IA006/F00001, Apeli i Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit me Shtojcën 1 publike, 7 korrik 2021 (konfidencial) (“Apeli”). Shih edhe F00371/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit, 30 qershor 2021 (originali është protokolluar më 25 qershor 2021) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>2</sup> Shih F00027, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 26 tetor 2020 (“Vendimi mbi Fletarrestimet”).

<sup>3</sup> Shih F00054, Njoftim i Pranimit të Jakup Krasniqit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 5 nëntor 2020.

<sup>4</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 61(a).

<sup>5</sup> Shih në përgjithësi Apelin.

riklasifikohet në kohën e duhur.

### III. CAKTIMI

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

#### **KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësin Kai Ambos**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për Apelin.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 8 korrik 2021  
Në Hagë, Holandë.